



NEWSLETTER

Gusht, 2021.

Nr.8

Ka filluar monitorimi i raportimit mediatik të transmetuesve për Zgjedhjet lokale 2021

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale më 6 gusht e informoi publikun se filloi monitorimin e i raportimit mediatik zgjedhor të radiodifuzerëve për Zgjedhjet lokale 2021.

Në periudhën deri në fillimin e fushatës zgjedhore, subjekt i mbikëqyrjes janë kanali i parë i programit televiziv të Shërbimit publik- MRT 1 dhe gjashtë televizione komerciale në nivel shtetëror të cilat kanë një shtrirje mesatare javore mbi 10% – TV Sitel, TV Kanal 5, TV Telma, TV Alsat-M, TV Alfa dhe TV 24Vesti. Të gjitha shërbimet e tjera softuerike do të monitorohen në bazë të ankesave.

Monitorimi përfshin programin e tyre të përgjithshëm, me vëmendje të veçantë në njoftimet qendrore të lajmeve dhe emisionet e veçanta informative ku marrin pjesë përfaqësues të pushtetit (qëndror/lokal), të partive politike dhe përfaqësues të tjerë potencial në zgjedhje. Do të monitorohen të gjitha programet e tjera në të cilat ka pjesëmarrës potencial në zgjedhje pa marrë parasysh arsyen e paraqitjes së tyre.

Si më parë, Agjencia, në faqen e saj të internetit, vendosi një banderolë me të gjitha materialet relevante për procesin zgjedhor-akte dhe akte nënligjore që lidhen me zgjedhjet, formular për sugjerime, publikime, raporte dhe të ngjashme. Duke pasur parasysh se me shpalljen e Zgjedhjeve lokale, të caktuara për 17 tetor 2021, hynë në fuqi dispozitat e Kodit zgjedhor, Agjencia u kujtoi të gjithë transmetuesve dispozitat relevante për periudhën para fillimit të fushatës zgjedhore. Përmbajtja e dispozitave është në dispozicion në faqen e internetit të Agjencisë, në [linkun e radhës](#).

Njoftim publik

Në lidhje me protestën publike, të organizuar nga një grup qytetarësh të nxitur nga masat e reja ndaj Koronavirusit, ndaj gazetarëve ishin drejtuar fyerje, mesazhe vulgare, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale më 17 gusht theksoi se një qëndrim i tillë paraqet një sulm verbal ndaj lirisë së medias dhe të drejtës së qytetarëve për informim.

Agjencia dënoi të gjitha format e poshtërimit dhe ofendimeve verbale ndaj gazetarëve dhe apeloj të respektohet dinjiteti i profesionit të gazetarit, si dhe dinjiteti personal i profesionalistëve të medias.

Në të njëjtën kohë, u theksua se sigurimi i kushteve për funksionimin e qetë të mediave është kushtë themelor për lirinë e informacionit.

Mbikëqyrje ndaj Operatorëve të rrjetit të komunikimit elektronik publik.

Mbikëqyrje e rregullt e programit për detyrimet që lidhen me regjistrimin e shërbimeve programore të Agjencisë dhe titllimin e programeve që i ritransmetojnë operatorët është kryer ndaj Kabel Net, Kabel-L-Net, Shkupi Kable, Viva Net, Multimedia – Net dhe Telenet Kom.

Mbikëqyrja konstatoi se operatori Kabel-Net nga Strumica, për përdoruesit e tij ritransmeton shërbime programor „Film Box Extra“ i cili nuk është i përfshirë në regjistrin e shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia, që bie në kundërshtim me nenin 141 nga LSHMAAV.



NEWSLETTER

Shqiptimi i masave vërejtje publike ndaj transmetuesve dhe ORRKE

Këshilli i Agjencisë në seancën e 23-të mbajtur më 24 gusht bazuar në konstatimet nga mbikëqyrja ekzistuese solli vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj TV Edo, Stit Televizion, Tv Koha dhe KTV Kavadarç.

Ndaj TV Edo vërejtje publike u shqiptua për shënimin pa paralajmërim për „program në të cilin janë klasifikuar produkte“ nga argëtuese-emisione dokumentare, në transmetim të paktën 30% të programit të krijuara fillimisht si vepra audiovizive maqedonase, nga minimumi ligjor i krijuar fillimisht si program audioviziv maqedonas, transmetimin e pop-al/reklama në ekran të ndarë që nuk e kalon periudhën e përcaktuar prej 15 minutash dhe mos publikimi i të dhënave në çështjet e transmetimit, të cilat duhet të transmetohen në vendin e duhur për secilën përmbajtje të shërbimit programor.

Ndaj Siti Televizionit vërejtje publike për mos shënim me një shenjë paralajmëruese dhe mos publikimin e të dhënave për përshtypjet në emisionet e dhëna, që duhet të transmetohen në vendin e caktuar për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Ndaj TV Koha vërejtje publike është shqiptuar për mostransmetim të gjysmës së programit të krijuar fillimisht si vepra audiovizive maqedonase, ndërkohë që ndaj KTV Kavadarç, për transmetim të pop-art/reklama me ekran të ndarë që nuk e kalon periudhën e caktuar më së paku prej 15 minutash.

Në seancën e 23-të, bazuar në konstatimet nga mbikëqyrja e kryer u konstatuan ritransmetim të shërbimit programor të paregjistruar bazuar në nenin 141 nga LSHMAAV, ndaj operatorit Kabel-Net nga Strumica u soll vendim për vërejtje publike dhe për përjashtimin nga ritransmetimi i shërbimit të ngadalshëm programor.

